




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
DREJTORIA E KURRIKULAVE, SIGURIMIT TË CILËSISË DHE
KËRKIMIT SHKENCOR

MIRATOHET

REKTORI

Prof. dr. Ali JASHARI



PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E KODIT TË CILËSISË SË ARSIMIT TË LARTË
AKREDITIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Bazuar në VKM nr. 531, datë 11.9.2018 "Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë" Drejtoria e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor në bashkëpunim me grupet e NJSBC-ve dhe njësitë bazë filloi punën për zbatimin e tij.

Puna për zbatimin e tij do të bazohet në planin e veprimit në të cilin do të përfshihen veprimtaritë, hapat, përgjegjësit dhe detyrat që do të zhvillohen në kuadër të akreditimit të programeve të studimit.

Plani i veprimit do të përfshijë hapat që do të ndiqen deri në përfundim të akreditimit të programeve të studimit.

Në tabelën e mëposhtme janë përcaktuar veprimtaritë, detyrat, përgjegjësit dhe afatet e zbatimit të kodit të cilësisë.

Përshkrim i veprimtarive që janë zhvilluar dhe që do të ndiqen:

Gjatë vitit akademik 2017-2018 pas përfundimit të procesit të akreditimit institucional u hartua plani i veprimit me detyrat e lëna nga procesi në fjalë. Duke qenë se Kodi i Cilësisë nuk ishte miratuar ende veprimtaria e NJSBC-së dhe departamenteve u përqendrua në përgatitjen e dokumentacionit për akreditimin e programeve të studimit. Përgatitja për akreditimin e programeve të studimit u përfshi në një nga pikat e planit të veprimit duke lënë një afat, brenda 6-mujorit të parë të vitit 2018 në përgatitjen e dokumenteve nga njësitë bazë për të gjitha programet e studimit sipas kërkesave të ASCAL.

Pas kësaj faze me miratimin e Kodit të Cilësisë, filloi puna për akreditimin e programeve të studimit.

Dokumentet ku do të bazohet për akreditimin e programeve:

- Kodi i Cilësisë së arsimit të lartë;
- Manuali "Për procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit 2017"

**PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E KODIT TË CILËSISË SË ARSIMIT TË LARTË
AKREDITIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT**

NR.	VEPRIMTARIA	PËRGJEGJËSIT	PROCEDURA	AFATE	SHËNIME
1.	Përgatitja për procesin e akreditimit të programeve të studimit	Njësitë bazë, NJSBC e njërive kryesore	Përgatitja e dokumenteve për të gjitha programet e studimit sipas kërkesave të ASCAL	Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2018	Përgatitja e dokumenteve i referohet përshtatjes së programeve të studimit me aktet nënligjore të miratuara.
2.	Miratimi i Kodit të Cilësisë dhe shpërndarja	Dekanët, NJSBC, SKSC, Përgjegjësit e njësisë bazë.	Shpërndarja e Kodit të Cilësisë dhe nxjerrja e detyrave	Brenda muajit shtator	Bazuar në standardet që përfshihen në Kodin e Cilësisë do të nxirren detyrat nga çdo departament për standardet të cilat kanë nevojë për plotësim.
3.	Takim me NJSBC	NJSBC, SKSC	Takim për ndarjen e detyrave lidhur me këtë proces	Java e fundit e shtatorit	Do të nxirren detyra konkrete për NJSBC-të të cilët do t'i zbatojnë në departamentet përkatëse
4.	Vlerësimi i gjendjes së programeve të studimit.	NJSBC-të, Njësitë bazë	Vlerësimi paraprak i gjendjes së programeve të studimit sipas standardeve të cilësisë të përcaktuara në kodin e cilësisë.	Java e fundit e shtatorit – Fillimi i muajit tetor.	Do të hartohen raporte të shkurtuara të përmbushjes së standardeve, dhe strategjitë e përmbushjeve të standardet ku ka mangësi.
5.	Kërkesa për trajnime	SKSC	Do të dërgohet kërkesa në ASCAL për trajnimin e stafit. Pas miratimit të kërkesës do të njoftohen pjesëmarrësit në trajnim për datën e zhvillimit.	Java e fundit e shtatorit	Në kuadër të akreditimit të programeve. Mund të kërkohet që trajnimi të zhvillohet nga ASCAL në UNIKO
6.	Trajnime	NJSBC-të, SKSC, ASCAL	Do të përcaktohet grupi i cili do të trajnohet fillimisht në ASCAL (përfaqësues nga çdo fakultet), do të trajnohen në ASCAL dhe më pas do të zhvillohen në UNIKO trajnime të grupeve në çdo departament. Nëse ASCAL do të zhvillojë trajnimin në UNIKO, do të përcaktohen grupet që do të marrin pjesë në trajnim	Javën e parë të tetorit	Të trajnuarit në ASCAL do të trajnojnë grupet e tjera në UNIKO nëse do të përdoret kjo formë.

7.	Aplikimi për akreditim programesh (Hapat e akreditimit të programeve)	SKSC, NJSBC-të, Njësitë bazë	Do të aplikohet për akreditim programi nëpërmjet sistemit AMS (Ascal Management System) Hapat sipas Manualit	1 tetor 2018 – 31 maj 2019	Sipas “Manualit për procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit 2017” Përfaqësuesit e NJSBC-ve të departamenteve do të menaxhojnë procesin e akreditimit të programeve në departamentin përkatës.
8.	Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për akreditim nga ASCAL	ASCAL	ASCAL shqyrton dhe miraton fillimin e procedurave për akreditim	Pas aplikimit	Shqyrton paraprakisht përputhshmërinë e kërkesës për akreditim.
9.	Dërgimi i faturës financiare për akreditim	ASCAL	ASCAL dërgon faturën financiare në UNIKO sipas tarifave të VKM-së	Pas aplikimit	VKM nr. 109, datë 15.2.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e ASCAL”
10.	Pagesa e faturës financiare	SKSC, DF	Kryerja e pagesës së faturës bankare dhe dërgimi në ASCAL.	Brenda 10 ditësh nga marrja e faturës financiare	Dërgimi do të bëhet në rrugë postare dhe nëpërmjet sistemit AMS. * nëse pagesa nuk kryhet brenda afateve, kërkesa anulohet.
11.	Dërgimi i konfirmimit	ASCAL	Pas dorëzimit të faturës bankare ASCAL dërgon letrën e konfirmimit në UNIKO	Pas kryerjes së pagesës	Që në këtë moment deri në marrjen e vendimit nga BA programi konsiderohet në proces akreditimi. Konfirmimi përcakton periudhën e akreditimit.
12.	Fazat e procesit të vlerësimit	ASCAL	Përgatitja për vlerësimin e brendshëm	Jo më shumë se 6 muaj nga dërgimi i konfirmimit	
13.	Përcaktimi i GVB (trajnimi)	UNIKO	Përcaktimi i GVB (emrat, kontaktet) dhe dërgimi i të dhënave në ASCAL Kërkesa për trajnim të GVB-së nga ASCAL	Gjatë procesit	NJSBC-të e njësive kryesore.
14.	Vlerësimi i brendshëm	GVB	Përgatitja e RVB-së sipas kërkesave të ASCAL	Sipas afatit në letrën e konfirmimit	Në shqip (Programet Profesionale, Bachelor, Master Profesional) Në shqip dhe Anglisht (Master i Shkencave)

15.	Pyetësorët e stafit dhe studentëve	ASCAL KI	Dërgohen listat e kontakteve nga KI	Gjatë hartimit të RVB, dhe dosjes	Duhet të përgjigjen mbi 20% e të anketuarve
16.	Vlerësimi i jashtëm	ASCAL	Ngritja e GVJ, vlerësimi i dosjes së akreditimit, informimi i GVJ për datat e vizitës në UNIKO,		
17.	Vizita në UNIKO	GVJ, ASCAL	Hartohet axhenda, miratohet dhe i komunikohet UNIKO	Pas verifikimit të dosjes së akreditimit	Vizita zgjat 1-3 ditë
18.	Hartimi i RVJ	GVJ, ASCAL	GVJ harton draftreportin, e dërgon në ASCAL. ASCAL e dërgon në UNIKO.	Pas vizitës nga GVJ	Nëse ka nevojë për ndryshime të cilat janë të argumentuara.
19.	Shqyrtimi i vlerësimit dhe vendimmarrja	BA	BA shqyrton dosjen dhe merr vendimin për akreditimin e programit të studimit	Sipas afateve të përcaktuara	
20.	Procedura e informimit, ankimimit dhe apelimit të vendimit	UNIKO	UNIKO ka të drejtën e informimit dhe ankimimit në çdo fazë të akreditimit.	Në çdo fazë të akreditimit	
21.	Plotësimi i mangësive	UNIKO	Plotësimi i rekomandimeve të lëna nga BA	Sipas afateve në vendim	Nëse ka

SHKURTESA:

UNIKO – Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë;

ASCAL – Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë;

AMS – Sistemi i Menaxhimit të të Dhënave të ASCAL

SKSC – Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë;

NJSBC – Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;

DF – Drejtoria e Financës

BA – Bordi i Akreditimit

GVB – Grupi i Vlerësimit të Brendshëm

RVB – Raporti i Vlerësimit të Brendshëm

KI – Koordinator i Institucional

GVJ – Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

RVJ – Raporti i Vlerësimit të Jashtëm